



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Komunës së Rahovecit për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. "Jugopetrol", parcela kadastrale Nr. 1817-0 dhe Objektivin që menaxhohet dhe administrohet nga AKI, i cili gjendet në parcelën Nr. 1318-1 në pronësi të Komunës së Rahovecit, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit" Zona Kadastrale: Rahovec, Komuna Rahovec, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktursë), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Rahovecit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

Fletëparaqitja e elaboratit të shpronimit të pronave të menagjuara nga AKM-ja e të cilat janë shpallur prona me interes publik për Komunën e Rahovecit															
Gjendja e vjetër								Gjendja e re							
Nr.	Zona Kadastrale	Pronar	Nr. i ngastrës	Kultura/Klasa	Sipërfaqja e kultures (m2)	Sipërfaqja e përgjithshme (m2)	Vërejtje	Nr.	Zona Kadastrale	Pronar	Nr. i ngastrës	Kultura/Klasa	Sipërfaqja e kultures (m2)	Sipërfaqja e përgjithshme për shpronësim (m2)	Vërejtje
1	RAHOVEC	DRUSHTVE NA SVOJINA JUGOPETRO L BEOGRAD	1817-0	JO PJELLO RE	691	691		1	RAHOVEC	KOMUNA E RAHOVEC IT	1817-0	JO PJELLO RE	691	691	Pikë Karburanti i cila është nën menaxhimin e AKP-së. Kërkohe për shpronësim nga Komuna e Rahovecit parcela si dhe objekti kryesor ndërtuar në parcelë si dhe të gjitha objektet tjera përcjellëse si rezervuaret të petroilit, dispoze gasi etj.

2	RAHOVEC	KOMUNA E RAHOVECIT	1318-1	TOKË TJETËR JO PJELLORE	2537	3331			2	RAHOVEC	KOMUNA E RAHOVECIT	1381-1	TOKË TJETËR JO PJELLORE	2537	794	Ngastra kadastrale është pronë e Komunës së Rahovecit, ndërsa ndërtesa në kuadër të kësaj ngastre është nën menaxhimin e AKP-së. Kërkohe shpronësimi i ndërtesës në sipërfaqe prej 794m2
				TOKË NDËRTIMORE SHITË PI-NDËRTESE	794								TOKË NDËRTIMORE SHITË PI-NDËRTESE	794		